

1633
31.3.2009

Emertimi dhe Forma Ligjore

"TOMOORI" SHPK

Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar

NIPT-I

J 62903162 K

Adresa e Selise

NE QENDER TE QYTETIT BERAT

Data e krijimit

20.02.1995

Nr. i Regjistrit Tregtar

9083

Veprimtaria kryesore

Hoteleri Bar Restorant



PASQYRAT FINANCIARE

Viti 2008

07.31.03.2009

R. DOGA

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga 01.01.2008 Deri 31.12.2008

DATA E MBYLLJES SE PASQYRAVE FINANCIARE 18.02.2009

PASQYRAT FINANCIARE JANE INDIVIDUALE INDIVIDUALE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE KONSOLIDUARA _____

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE SHPREHURA NE LEKE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE RRUMBULLAKOSURA NE O LEKE

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

PËR ORTAKET E SHOQËRISË "TOMORRI" sh.p.k

Adresa: Lagja "28 NENTORI" Ne qender te qytetit Berat

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë "TOMORRI" sh.p.k Berat, të cilat përbëhen nga Bilanci Kontabël i datës 31 Dhjetor 2008, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyra e fluksit të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje e metodave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera anekse.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Shqiptare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi yne u be në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qellim që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale. Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qellim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne nuk e vëzhguam inventarizimin fizik të fundit të periudhës, të datës 31 Dhjetor 2008, meqë ajo datë ishte para datës që ne u angazhuam fillimisht si auditues të shoqërisë. Për shkak të mënyrës së rregjistrimeve te shoqerise, ne nuk ishim në gjëndje që, duke u nisur nga procedura të tjera auditimi, të bindeshim në lidhje me sasinë e stokut.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të rregullimeve, në qoftë se do të kishte ndonjë të tillë, që mund të ishin përcaktuar të nevojshme për t'u bindur përsa i përket sasive të stokut, pasqyrat financiare japin një imazh të vërtetë dhe të sinqertë të gjëndjes financiare të shoqërisë "TOMORRI" sh.p.k më datë 31 Dhjetor 2008, të rezultatit te saj financiar dhe te flukseve te saj te parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Shqiptare të Raportimit Financiar.

EKSPERT KONTABËL I AUTORIZUAR

Dhimo DUNDO

Berat më, 29.03.2009

Adresa:

Dhimo Dundo: "Shtëpia e Ushtarakëve Berat", cel. 069 20 99 203; 032 238360

Pasqyra e bilancit kontabel me 31.12.2008

	ZERI I BILANCIT	She nime	Viti 2008	Ushtrimi paraardhes
A	AKTIVET			
I	Aktivët Afatshkurtëra			
1	Mjete monetare	3	347,309	176,587
2	Derivative dhe aktive financiare të mbajtura për tregtim		0	0
(i)	-Derivatet		0	0
(ii)	-Aktivet e mbajtura për tregtim		0	0
	Totali 2		0	0
3	Aktive të tjera financiare afatshkurtra		752,932	272,885
(i)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	4	558,475	272,885
(ii)	Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	5	194,457	0
(iii)	Instrumente të tjera borxhi		0	0
(iv)	Investime të tjera financiare		0	0
	Totali 3		752,932	272,885
4	Inventari	6	36,952,884	29,605,202
(i)	Lëndët e para	6	6,271,712	4,634,062
(ii)	Prodhim në proces	6	0	0
(iii)	Produkte të gatshme	6	0	0
(iv)	Mallra për rishitje	6	30,681,172	24,971,140
(v)	Parapagesat për furnizime	6	0	0
	Totali 4		36,952,884	29,605,202
5	Aktivët biologjike afatshkurtra		0	0
6	Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje		0	0
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	7	0	0
	Totali i aktiveve afatshkurtera (I)		38,053,125	30,054,674
II	Aktivët afatgjata		0	0
1	Investimet financiare afatgjata		0	0
(i)	Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara		0	0
(ii)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje		0	0
(iii)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë		0	0
(iv)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme afatgjata		0	0
	Totali 1.		0	0
2	Aktive afatgjata materiale	8	61,959,071	62,539,038
(i)	Toka	8	1,692,000	1,692,000
(ii)	Ndërtesa	8	34,734,743	35,133,908
(iii)	Makineri dhe pajisje	8	24,105,772	24,392,574
(iv)	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	8	1,426,556	1,320,556
	Totali 2		61,959,071	62,539,038
3	Aktivët Biologjike afatgjata		0	0
4	Aktivët afatgjata jomateriale		0	0
(i)	Emri i mire		0	0
(ii)	Shpenzimet e zhvillimit		0	0
(iii)	Aktive të tjera afatgjata jomateriale		0	0
	Totali 4		0	0
5	Kapital aksionar i papaguar		0	0
6	Aktive të tjera afatgjata		0	0
	Totali i aktiveve Afatgjata (II)		61,959,071	62,539,038
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		100,012,196	92,593,712

"TOMORRI" shpk

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2008 dhe shënimet shpjeguse

Shumat shprehen në lekë

B	DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	Detyrimet Afatshkurtëra			
1	Derivativët		0	0
2	Huamarrjet	8	2,816,450	0
(i)	Huat dhe obligacionet afatshkurtra	8	0	0
(ii)	Kthimet/ripagesat e huave afatgjata	8	2,816,450	
(iii)	Bono të konvertueshme		0	
	<i>Totali 2</i>		2,816,450	0
3	Huat dhe parapagimet	9	4,020,785	2,231,872
(i)	Të pagueshme ndaj furnitorëve	9	3,680,588	1,947,115
(ii)	Të pagueshme ndaj punonjësve	9	0	0
(iii)	Detyrime tatimore	9	340,197	284,757
(iv)	Hua të tjera	9	0	0
(v)	Parapagimet e arkëtuara	9	0	0
	<i>Totali 3</i>		4,020,785	2,231,872
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		0	
5	Provizionet afatshkurtra		0	
	<i>Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)</i>		6,837,235	2,231,872
II	Detyrime afatgjata		0	
1	Huat afatgjata	10	5,482,235	13,679,000
(i)	Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare	10	5,482,235	13,679,000
(ii)	Bonot e konvertueshme		0	
	<i>Totali 1</i>		5,482,235	13,679,000
2	Huamarrje të tjera afatgjata	11	20,000,000	14,500,000
3	Provizionet afatgjata		265,290	265,290
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		0	0
	<i>Totali i detyrimeve afatgjata (II)</i>		25,747,525	28,444,290
	<i>Totali i detyrimeve (I+II)</i>		32,584,760	30,676,162
III	Kapitali		0	
1	Aksionet e pakicës		0	0
	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë			
2	mëmë		0	0
3	Kapitali aksionar	12	200,000	200,000
4	Primi i aksionit		0	0
5	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)		0	0
6	Rezerva statusore		0	0
7	Rezerva ligjore	12	38,186	38,186
8	Rezerva të tjera	12	52,614,137	48,906,183
9	Fitimet e pashpërndara		9,065,227	9,065,227
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar	13	5,509,886	3,707,954
	<i>Totali i kapitalit (III)</i>		67,427,436	61,917,550
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)		100,012,196	92,593,712

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-14

"TOMORRI" shpk

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2008 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të Periudhës 1 Janar 2008 deri më 31 Dhjetor 2008

(Bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres)

		Shëni me	Viti ushtrimor 2008	Ushtrimi paraardhes
1	Shitjet neto	13,1	19,468,019	18,067,206
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	13,2	0	0
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces		0	0
4	Materialet e konsumuara	13,3	(768,220)	(812,913)
5	Kosto e punes	13,5	(7,582,392)	(6,420,898)
	<i>Pagat</i>		(6,230,400)	(5,276,008)
	<i>Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetsore</i>		(1,351,992)	(1,144,890)
6	Amortizimi dhe zhvleresimet	8	(692,167)	(692,167)
7	Shpenzime te tjera	13,4	(4,184,234)	(4,102,034)
8	Totali i shpenzimeve (shuma 4-7)		(13,227,013)	(12,028,012)
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+3-8)		6,241,006	6,039,194
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e		0	0
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		0	0
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	13,6	0	0
12,1	<i>Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata</i>		0	0
12,2	<i>Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi</i>		(984,604)	(1,399,251)
12,3	<i>Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi</i>		869,027	0
12,4	<i>Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare</i>		0	0
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)		(115,577)	(1,399,251)
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9+10+11+12+/-13)	13,7	6,125,429	4,639,943
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	13,7	615,543	931,989
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	13,7	5,509,886	3,707,954
17	Elementet e pasqyrave te konsoliduara			0

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-14

"TOMORRI" shpk

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2008 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e Fluksit monetar për Periudhën 1 Janar 2008 deri më 31 Dhjetor 2008

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	She nime	Viti ushtrimor 2008	Ushtrimi paraardhës
Fluksi i monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit	13.7	6,125,429	4,639,943
<i>Rregullime për:</i>			0
Amortizimin	8	692,167	1,016,715
Humbje nga kembimet valutore			0
Të ardhura nga investimet	13.2	0	0
Shpenzime per interesa	13.6	984,742	1,399,397
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti si dhe e kërkesave të tjera		(480,047)	1,000
Rritje/renie në tepricën e inventarit		(7,347,682)	(8,346,190)
Rritje/renie në tepricën e detyrimeve për të paguar nga aktiviteti		4,605,363	(7,032,934)
Mjetet monetare të perfituara nga aktivitetet		4,579,972	(8,322,069)
Interesi i paguar		(984,742)	(1,399,397)
Tatimfitimi i paguar	13.7	(615,543)	(931,989)
		0	324,549
			0
<i>Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		2,979,687	(10,328,906)
			0
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			0
Blerje e shoqërisë së kontrolluar _____ minus parate e arketuara			0
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	8	(112,200)	0
Të ardhura nga shitja e paisjeve	13.2	0	0
Interesi i arketuar			0
Dividendet e arketuar			0
			0
<i>Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese</i>		(112,200)	0
			0
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			0
Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner			0
Të ardhura nga huamarrje afatgjata	10.11	(2,696,765)	10,375,525
Pagesa e detyrimeve të qirës financiare			
Dividendet e paguar		0	0
		0	0
<i>Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare</i>		(2,696,765)	10,375,525
			0
			0
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		170,722	46,619
			0
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		176,587	129,968
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		347,309	176,587

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-14

"TOMORRI" shpk

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2008 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

**Pasqyra e ndryshimeve të Kapitalit gjatë Periudhës 1 Janar 2008 deri më 31 Dhjetor 2008
ne nje pasqyre te pakonsoliduar**

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione te thesarit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 Dhjetor 2006	200,000	-	-	46,021,491	11,988,105	58,209,596
Efekti ndryshimeve ne politikat kontabël	-	-	-	-	-	-
Pozicioni I rregulluar	200,000	-	-	46,021,491	11,988,105	58,209,596
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	3,707,954	3,707,954
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	2,922,878	(2,922,878)	-
Emetimi i aksioneve(pjeseve te reja te kapitalit)	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2007	200,000	-	-	48,944,369	12,773,181	61,917,550
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	5,509,886	5,509,886
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Emetim i kapitalit aksionar (pjeseve te reja)	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	3,707,954	(3,707,954)	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2008	200,000	-	-	52,652,323	14,575,113	67,427,436

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-14

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT 2008

1. Informacione te pergjitheshme

"TOMORRI" sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me vendim te Gjykates se rrethit Gjyqsor Tirane nr. 9083 date 20.02.1995 dhe gjendet e rregjistruar ne rregjistrin tregtar(QKR), identifikuar me NIPT J62903162K. Kapitali i rregjistruar aktualisht eshte 200.000 leke dhe zoterohet ne pjese te barabarta nga ortaket Albert Lamce dhe Tomorr Reovica.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2008 eshte sherbime hotelerie e bar restorant.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standardet Kombetare te Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke u kombinuar me elemente te metodave te tjera, dhe parimit te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit zbatohen per here te pare dhe aplikimi i tyre, sipas kerkesave te SKK-ve, eshte bere ne menyre perspektive. Si pasoje shifrat e vitit 2008 nuk jane te krahasueshme me ato te vitit 2007, pasi jane zbatuar politika kontabel të ndryshme.

Ne ndertimin e pasqyrave financiare te vitit 2008 jane zbatuar kerkesat e SKK-2, dhe per rrjedhim ne krahasim me vitin e kaluar, ndryshon formati i Bilancit Kontabel dhe i Pasqyres se te Ardhurave dhe Shpenzimeve. Ndertimi i pasqyrave financiare sipas formatit te ri te percaktuar ne SKK-2 eshte bere duke riklasifikuar zerat e bilancit te vitit 2007 ne zerat e bilancit te ri.

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogariten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zerat monetarë shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me

kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2008 janë 1 euro=123.8 leke dhe 1 dollar= 87.91 leke.

Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2008 është 10 % nga 20% që ka qene në ushtrimin e mëparshëm.

Kërkesat për t'u arkëtuar dhe detyrimet për t'u paguar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në para, në përgjithësi, paraqiten në bilanc me koston e amortizuar. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare.

Inventaret

Vlerësimi në hyrje i inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjelle inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimitit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto e realizueshme.

3. Aktive monetare (likuiditete ne banke dhe arke)

Gjendjet e mjeteve monetare, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2007 dhe 31 Dhjetor 2008 jane si me poshte:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2008		Gjendja ne 31.12.2007	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	leke	347,165		61,346	
Arka	leke	144		115,241	
Shuma Mjete monetare		347,309	x	176,587	x

Gjendjet e llogarive te mjeteve monetare te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare te bankave perkatese dhe inventaret fizike.

4. Aktive te tjera financiare afatshkurtera-Llogari/Kerkesa te arketueshme

Llogari/Kerkesa te arketushme jane te perbera si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Kliente per mallra, produkte e sherbime	558,475	272,885
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per mallra, prod.e sherb	0	0
Kliente per aktive afatgjata		
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per aktive afatgjata		
Shuma Kerkesa te arketueshme	558,475	272,885

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme" jane pasqyruar vlerat e akumuluar te situacioneve te ndertimit (faturave) te apartamenteve qe shoqeria nderton per shitje me fondet e veta, kerkesa te tjera te arketueshme ndaj klienteve per shitjen e mallrave dhe sherbimeve si dhe tepricat debitore te marrdhenieve me furnitoret.

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

5. Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme

Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme jane te perbera si vijon :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Shteti per tatime dhe taksa	194,457	0
Shteti-Tatim mbi fitimin (teprica debitore)	194,457	0
Shteti-TVSH per tu marre		0
Shuma	194,457	0

Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" perfaqesojne tepricen debitore te "Shteti-tatim mbi fitimin" me 31.12.2008 per 281.360 leke.

"TOMORRI" shpk

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2008 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

6. Inventari

Inventari është i përbërë si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Lende te para		
Materiale te para dhe materiale te tjera	6,271,712	4,634,062
Inventari i imet dhe ambalazhi (afatshkurter)	0	0
Shuma Lende te Para	6,271,712	4,634,062
Mallra per Rishitje	30,681,172	24,971,140
Parapagime per furnizime	0	0
Shuma inventar	36,952,884	29,605,202

Vlerat e inventarit të paraqitura me sipër përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike e kryer në fund të ushtrimit 2008. Veprimet ekonomike që lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar në llogaritë e rezultatit me mënyrën e inventarit të ndërmjetem. Si politike kontabel në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda "FIFO".

Drejtimi mendon se vlerat e paraqitura janë vlera me e ulët mes kostos së marrjes dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk është nevojë për zhvlerësime të inventareve.

7. Aktive afatgjata materiale

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM-te) përbehen si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertime	Instalime teknike, makineri pajisje, etj.	Mjete transporti	Pajisje zyre e informatike	Inventar i imet afatgjate	Totali
Kosto e AAM me 01.01.2008	1,692,000	39,916,530	27,080,277	200,000	62,000	1,336,056	70,286,863
Shtesat 2008	0	0	0	0	0	112,200	112,200
Pakesimet 2008	0	0	0	0	0	0	0
Kosto e AAM me 31.12.2008	1,692,000	39,916,530	27,080,277	200,000	62,000	1,448,256	70,399,063
Amortizimi AAM 01.01.2008	0	4,782,622	2,679,703	208,000	77,500	0	7,747,825
Amortizimi ushtrimor	0	399,165	270,802	16,000	6,200	0	692,167
Amortizimi per daljet AAM	0	0	0	0	0	0	0
Amortizimi i AAM me 31.12.2008	0	5,181,787	2,950,505	224,000	83,700	0	8,439,992
Vlera neto e AAM 31.12.2007	1,692,000	35,133,908	24,400,574	(8,000)	(15,500)	1,336,056	62,539,038
Vlera neto e AAM 31.12.2008	1,692,000	34,734,743	24,129,772	(24,000)	(21,700)	1,448,256	61,959,071

Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit dhjetor 2008. Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me koston e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

"TOMORRI" shpk

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2008 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime. Shuma e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

8. Detyrimet Afatshkurtera-Huamarrjet

Huamarrjet (afatshkurtera) perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Hua dhe obligacione afatshkurtera		
Llogari bankare te zbuluara(overdrafte	0	0
Hua ne leke		
Hua ne monedha te huaja		
Huamarrje afatshkurtera(Bankat)		
Shuma hua dhe obligacione afatshkurtera	0	0
Kthimet/ipagesat e huave afatgjata	2,816,450	
Shuma huamarrjet	2,816,450	0

"Kthimet / ripagesat e huave afatgjata" perfaqeson keset e kredise afatgjate qe do paguhen brenda 12 muajve te ardhshem te marre ne "ProCredit" Bank sha dhe eshte parashikuar te kthehet deri ne 31.12.2009. Shih shenimin nr.10 ne te cilin jane trajtuar kredite e marra.

9. Detyrimet Afatshkurtera-Huate dhe Parapagimet

Huate dhe parapagimet perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Te pagueshme ndaj furnitoreve		
Furnitore per mallra, produkte e sherbime	3,680,588	1,947,115
Te pagueshme ndaj punonjesve		
Detyrime ndaj personelit per paga dhe shperblime	0	0
Paradhenie per punonjesit		
Shuma Te pagueshme ndaj punonjesve	0	0
Detyrime tatimore		
Detyrime per sigurime shoqerore shendetsore	176,291	146,681
Shteti per tatime e taksa		
Tatim mbi te ardhurat personale	28,520	22,520
Tatim mbi fitimin	0	11,743
Tvsh per tu paguar	135,386	103,813
Shuma Shteti per tatime e taksa	163,906	138,076
Shuma Detyrime Tatimore	340,197	284,757
Hua te tjera		
Debitore te tjere kreditore te tjere	0	0
Dividende per tu paguar	0	0
Shuma hua te tjera	0	0
Parapagimet e arketuara	0	0
Shuma Huate dhe Parapagimet	4,020,785	2,231,872

"TOMORRI" shpk

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2008 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likuiduar në fund të ushtrimit. Shoqëria ka përgatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mbajtura për çdo furnitor. Drejtimi mendon se të drejtat e furnitoreve janë të vlerësuara realisht.

"Detyrimet për sigurime shoqërore e shëndetësore" përfaqësojnë detyrimin për sigurimet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor 2008.

"Shteti për tatim taksë" pasqyrojnë detyrimin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatimin mbi të ardhurat personale në 31 Dhjetor 2008.

10. Detyrimet Afatgjata-Huamarrjet Afatgjata

Huamarrje afatgjata përbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Hua bono dhe detyrime nga qeraja financiare		
Bankat	5,482,235	13,679,000
Obligacionet		
Qeraja financiare		
Shuma Hua bono dhe detyrime nga qeraja financiare	5,482,235	13,679,000
Shuma Hua afatgjata	5,482,235	13,679,000

Në vitin 2003 nga "ProCredit" Bank sh.a është marrë hua afatgjatë prej 150.000 Eur, për një periudhë 5 vjeçare e pagueshme me kështu mujore. Gjendja e saj më 31.12.2008 është 9.573 Eur ose 1.185137 leke dhe është klasifikuar teresisht afatshkurter pasi do të shlyet në muajin prill 2009. Po në "ProCredit" Bank sh.a është marrë në vitin 2007 hua në shumën 65.000 Eur me afat kthimi 5 vjet e kthyeshme me kështu mujore. Nga kjo hua janë klasifikuar si afatshkurter për kthim në vitin 2009 1.631.313 leke dhe 5.482.236 leke afatgjatë.

11. Detyrime Afatgjata-Huamarrje të tjera Afatgjata

Huamarrje të tjera afatgjata përbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Te drejta dhe detyrime ndaj ortakëve	20,000,000	14,500,000
Parapagime të marra		0
Shuma huamarrje të tjera afatgjata	0	143,283,507

Pallati që shoqëria po ndërton do të përfundojë në vitin 2009 prandaj parapagimet e marra u klasifikuan si afatshkurterë shih shënimin nr.9.

12. Kapitale të veta

Kapitali i rregjistruar i shoqërisë përbehet si vijon:

"TOMORRI" shpk

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2008 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Kaitali i paguar	200,000	200,000
Kapitali i nenshkruar i papaguar		
Shuma Kapitali themeltar	200,000	200,000

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në bilanc, është i njëjti me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në QKR. Me 31.12.2008 ai është 34.320.000 lekë. Gjate ushtrimit kontabel 2008 nuk ka ndryshim në kapitalin e regjistruar të shoqërisë dhe në raportet e zoterimit nga ortakët.

13. Fitimi(humbja) e vitit financiar

13.1 Shitjet neto

Shitjet neto perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Shitje e produkteve të gatshme	9,224,272	7,715,553
Shitja e punimeve dhe e shërbimeve	2,820,971	1,716,226
Shitje mallrash	7,422,776	8,635,427
Shuma Shitje neto	19,468,019	18,067,206

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. (Njohja dhe vlerësimi janë bazuar në SKK8).

13.2 Shpenzimet për Mallrat, lendet e para dhe shërbimet

Shpenzimet për Mallrat, lendet e para dhe shërbimet perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Blerje/Shpenzime të materialeve	0	61,303
Blerje/Shpenzime të materialeve të tjera	0	0
Blerje/Shpenzime mallrash e shërbimesh	768,220	751,610
Blerje/Shpenzime të tjera		
Shuma Mallrat lendet e para dhe shërbimet	768,220	812,913

Konsumi i mallrave, materialeve, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumën e paguara ose të pagueshme dhe i perkasin ushtrimit 2008.

13.3 Shpenzime të personelit

Shpenzime të personelit perbehen si vijon:

"TOMORRI" shpk

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2008 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Pagat dhe shperblimet e personelit	6,230,400	5,276,008
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	1,351,992	1,144,890
Kontribute dhe kuota te tjera per personelin		
Shuma Shpenzime te personelit	7,582,392	6,420,898

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

13.4 Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Shpenzime nga trete dhe shpenzime te tjera		
Blerje Energji avull uje	3,599,127	3,253,656
Shpenzime per sherbimet bankare	19,644	63,325
Materiale kancelari etj	0	0
Kuota e shpenzimeve per tu shpendare	0	324,548
Shuma shpenzime	3,618,771	3,641,529
Tatime dhe taksa		
Taksa dhe tarifa vendore	535,463	440,505
Tatime te tjera	0	0
Shuma tatime dhe taksa	535,463	440,505
Gjoha demshperblime	30,000	20,000
Shuma Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	4,184,234	4,102,034

Shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumen e paguar ose te pagueshme.

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit.

"Gjoha e demshperblime" perfaqesojne detyrimet dhe saksionet tatimore te rezultuara nga njoftim vleresimet e vitit 2008. Ato jane rimarre ne fitimin tatimor, shenimi nr.13.6.

13.5 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet financiare:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat		
Te ardhurat nga interesat	138	146
Shpenzime per interesa	984,742	1,399,397
Shuma te ardhura dhe shpenzime nga intersat	(984,604)	(1,399,251)
Fitim nga kembimet valutore	869,027	0
Humbje nga kembimet valutore	0	0
Shuma Fitimet/humbjet nga kursi i kembimit	869,027	0
Shuma e ardhurat dhe shpenzimet financiare	(115,577)	(1,399,251)

13.6 Shpenzimet e Tatim fitimit

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2008 dhe 2007 jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	6,125,429	4,639,943
II SHPENZIME TE PA ZBRITESHME (+)	30,000	20,000
1 Amortizimi tej normave fiskale		
2 Shpenzime per pritje e dhurime tej kufirit tatimor		0
3 Gjoha, penalitete, demshperblime	30,000	20,000
4 Provizione qe nuk njihen		
5 Shpenzime pa dokumenta te rregullta		
6 Te tjera		
III PJESA E HUMBYES SE MBARTUR (-)		
IV FITIM (HUMBJA) TATIMORE (I+II-III)	6,155,429	4,659,943
V SHPENZIMET E TATIMIT MBI FITIMIN (10%)	615,543	931,989
VI FITIMI(HUMBJA) NETO E USHTRIMIT(I-V)	5,509,886	3,707,954

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

14. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , ne 31 dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

15. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare. Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2008 shoqeria ka stabilitet dhe zhvillim normal te biznesit. Drejtimi mendon se nuk ka rreziqe te nderprerjes se veprimtarise se saj per vitin ne vazhdim.

16. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2007 jane riklasifikuar per tu pershtatur prezantimit te pasqyrave financiare te vitit 2008, te cilat jane ndertuar sipas SKK-ve qe aplikohen per here te pare dhe ne menyre prospektive. (shih shenimin nr.2)

HARTUESI

PELLUMB KORECI

PER DREJTIMIN E "TOMORRI SH.P.K

ADMINISTRATORI

ALBERT LAMCE

"TOMORRI" SHPK
HOTEL BAR RESTORANT
BLAGAJ ALBAJIAJPEX